

	REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVA KOMUNA E RAHOVECIT OPSTINA ORAHOVAC MUNICIPALITY OF RAHOVEC	
---	--	---

Për:	Operatori Ekonomik: "SAMIRE OSMANI B.I. (EKO PASTRIMI DDD)" me adresë në Suharekë Operatorëve Ekonomik Të gjitha palëve të interesuar
Nga:	Astrit Mullabazi, Menaxher i Zyrës së Prokurimit 
Lënda:	VENDIM për Rishqyrtim të Kërkesës
Datë:	17.06.2021

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Rahovecit, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 8.1.1) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas Kërkesës për Rishqyrtim, të datës: 14.06.2021, të parashtruar nga Operatori Ekonomik: "SAMIRE OSMANI B.I. (EKO PASTRIMI DDD)" me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEZINFEKTIM, DERATIZIM DHE DEZINESKTIM**, me Numër të prokurimit: 623-21-1818-2-2-1, Nr. i brendshëm: 623-21-014-2-2-1, nxjerr:

VENDIM

- I. **REFUZOHET** e pa bazuar kërkesa e parashtruar nga Operatori Ekonomik: "SAMIRE OSMANI B.I. (EKO PASTRIMI DDD)" me adresë në Suharekë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **DEZINFEKTIM, DERATIZIM DHE DEZINESKTIM**, me Numër të prokurimit: 623-21-1818-2-2-1, Nr. i brendshëm: 623-21-014-2-2-1, kundër Njoftimit mbi vendimin e AK – së, të datës: 09.06.2021, të publikuar në web – faqe: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- II. Autoriteti Kontraktues vendos të vazhdoj me Njoftim Mbi Vendimin e Autoritet Kontraktues për aktivitetin e prokurimit: **DEZINFEKTIM, DERATIZIM DHE DEZINESKTIM**, me Numër të prokurimit: 623-21-1818-2-2-1, Nr. i brendshëm: 623-21-014-2-2-1.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronik në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik: **“SAMIRE OSMANI B.I. (EKO PASTRIMI DDD)”** me adresë në Suharekë, me datën: **14.06.2021** si palë e pa kënaqur ndaj Njoftimit mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues të datës: **09.06.2021** ka paraqitur Kërkesë për Rishqyrtim sipas nenit 108/A, të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP) me Nr. 04/L-042, për aktivitetin e prokurimit: **DEZINFEKTIM, DERATIZIM DHE DEZINESKTIM**, me Numër të prokurimit: **623-21-1818-2-2-1**, Nr. i brendshëm: **623-21-014-2-2-1**, duke supozuar se janë shkelur dispozitat e Nenit 1, 6, 7, 28, 56 dhe 59 të LPP-së.

Autoriteti Kontraktues me datë: 17.06.2021 brenda afatit ligjor ka shqyrtuar të gjitha pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës ku ka konstatuar si vijon:

Qëndrojnë arsyet e eliminimit nga Autoriteti Kontraktues dhe se oferta e Operatorit Ekonomik: **“SAMIRE OSMANI B.I. (EKO PASTRIMI DDD)”** me adresë në Suharekë, është e papërgjegjshme administrativisht.

Baza Ligjore të kërkesës

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 1:

Lidhur pretendimin tuaj se ju keni të vendosur *sigurimin e tenderit konform kërkesës* nuk qëndron, pasi që ne si Autoritet Kontraktues kemi konstatuar se ju nuk keni ofruar ashtu siç është kërkuar konform Njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit.

Sigurimi i tenderit *nuk është i nënshkruar* nga ana e kompanisë së sigurimeve “ELSIG” sh.a, andaj nuk kemi mundur të bëjmë favorizime të pranojmë këtë dokument si valid e ta dëmtojmë operatorin i cili e ka dorëzuar sigurimin e tenderit konform kërkesës, një veprim i till do ta dëmtonte procesin e vlerësimit në mënyrë korrekte, dhe se do të cilësohej si standard i dyfisht.



ELSIG

Kompania e Sigurimeve Sh.A./Insurance Company J.S.C.

Gjithcka që duhet ta keni

Deklaratë e Garantuesit

SIGURIA E TENDERIT

Pjesë përbërëse e Polices me Nr. 93123

Për-KUVENDI KOMUNAL-RAHOVEÇË

(Emri i "Autoritetit Kontraktues")

Në emër të Samire Osmani B.J.

(emri dhe adresë e "Operatorit Ekonomik" dhe nr. i biletës në vëzhdim Operatorit Ekonomik)

Titulli i aktivitetit të prokurimit: **DEZINFEKTIM, DERATIZIM DHE DEZINESKTIM**

Nr. prokurimit: 623-21-1818-2-2-1, Nr. brendshëm: 623-21-014-2-2-1

Garancion me kërkesë të parë

Derisa operatori ekonomik i lartcukur, ka ndërmarrë veprimet për të dorëzuar një siguri të tenderit duke iu referuar dosjes së tenderit me numër të prokurimit të lartcukur, të dërguar nga autoriteti kontraktues, dhe ngase tenderuesi dëshiron të depozitoi garancinë në shumën e saktësuar në dosjen e tenderit, dhe ngase jemi pajtuar t'i japim tenderuesit këtë garanci.

Andaj me këtë konfirmojmë se jemi garantues dhe përgjegjës para jush, në emër të operatorit ekonomik, deri në një shumë totale: **1,000.00€** zotohemi të ju paguajmë, që me kërkesën tuaj të parë me shkrim në të cilën deklarohet mospërputhja e njërit nga kushtet në vijim:

- Autoriteti kontraktues konstatoi në bazë të dëshmive të vertetuara objektivisht se tenderuesi i ka dhënë informacione përmbajtësi të gabueshme ose masoqësive autoritetit kontraktues
- Tenderuesit tërheq tenderin e tij pas skadimit të afatit të fundit për dorëzim të tenderëve, por para skadimit të periudhës së vlefshmërisë së tenderit të përcaktuar në dosje të tenderit
- Tenderuesit iu është dhënë kontrata në fjalë në bazë të tenderit të tij dhe tenderuesi e refuzoi apo dështoi:
 - Që të depozitoi sigurinë e kërkuar në të specifikuar në dosje të tenderit
 - Të plotësojë të gjitha kushtet që përshkruan nënshkrimin të kontratës në fjalë siç është përcaktuar në dosjen e tenderit
 - Të lidhë kontratë që përshkruan afatet dhe kushteve të saktësuar në dosjen e tenderit

Pagesa në shumën e limituar prej **1,000.00€** siç është lartcukur, pa pasur nevojë të vertetoni apo të tregoni arsyeve ose shkakun e kërkesës tuaj, apo për shumën e specifikuar këtu.

Kjo siguri vlenë 120 ditë kalendrike prej 21.05.2021 deri më 18.09.2021

Data tëshimit: 21.05.2021

Nënshkrimi dhe vulë e garantuesit

Bazuar në tabelarin e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ në faqen 90 kemi shembullin se si duhet vepruar:

Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-se
Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 2:

Lidhur me pretendimin tuaj se ju *keni ofruar listën e stafit* prej gjashtë (6) punëtorëve për përdorimin e produkteve të DDD-së me përvojë tre (3) vjeqare nuk qëndron, pasi që ne si Autoritet Kontraktues kemi konstatuar se ju keni ofruar CV-të për punëtorët mirëpo në CV-të e tyre shihet se përvoja e punës nuk është ashtu siç është kërkuar konform Njoftimit për kontratë dhe dosje të tenderit për tre (3) vjet, por në CV-të e tyre shihet përvoja prej Një (1) vjet. Nëse ju keni pasur dilema për këtë kërkesë keni mundur që brenda afatit të lejuar ligjor të kërkonit sqarime.

Bazuar në tabelarin e Rregullave dhe Udhëzuesit Operativ në faqen 89 kemi shembullin se si duhet vepruar:

Shembujt e mëposhtëm nuk janë të vetmet raste. Varësisht nga rasti i paraqitur AK duhet të veprojë në përputhje me nenin 72 dhe nenin 59 të LPP-se

Problemi	Si të veprohet?	Neni i LPP-se
CV-ja e dorëzuar nuk përmbush kërkesat	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtejshëm	69

PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 3:

Lidhur me pretendimin tuaj se jeni eliminuar padrejtësisht lidhur me *listën e paisjeve* përkatësisht *paisjen ULV aerosol* nuk qëndron.

Ju nuk keni arritur të dorëzoni dëshmi lidhur me këto paisje. Ju keni vendosur në ofertë paisje të cilat nuk kanë qenë konform kërkesës dhe se të njëjtat janë pranuar si *DONACION*. Nëse ju keni pasur dilema për këtë kërkesë keni mundur që brenda afatit të lejuar ligjor të kërkonit sqarime të tjera.



Kompania Samire Osmani B.I

Makinerite ne Dispozicion te SAMIRE
OSMANI B.I jane sikur ne vijim:

1. ULV elektrostatische 20 cope
- 2.Pompa Dore LV elektrike (Nebulizator elektrike dore) 10 copa
- 3.Pompa dore Profesionale per sperkatje 13 cope
- 4.Fumigator-Thermal Fogen 2 cope
5. Fumigator-Thermal Fogen 1 COPE qe montohet ne kamionet
- 6.Pompa motorike 9 copa



PËRGJIGJE PËR PRETENDIMI ANKIMOR Nr. 4:

Lidhur me pretendimin tuaj *se ju keni dorëzuar dëshmi në gjuhë zyrtare të prepareteve* të dorëzuara në ofertën tuaj nuk qëndron, sepse në ofertën tuaj ju keni dorëzuar disa dokumente të cilat nuk janë zyrtare gjë që komisioni i vlerësimit e ka pasur të pamundur vlerësimin e tyre.

Neni 13

Përdorimi i gjuhëve në dokumentet e prokurimit publik

4. Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze.

Andaj pretendimet tuaja janë të pabazë se ne nuk ju kemi trajtuar në baze të Nenit 7, 10 dhe 59 të LPP-së, sepse në kërkesat tonë çdo gjë është specifikuar dhe kanë qenë kërkesa të vendosura, dhe vlerësimi i ofertave është bërë në mënyrë të drejtë konform Nenit 59 të LPP-së.

Sa i përket akuzave tuaja lidhur me favorizime dhe atakimin e zyrës së prokurimit, duhet të keni kujdes në të ardhmen kur deklaroheni pasi që ju jepni përgjegjësi para organeve të tjera lidhur me akuzat të cilat i bëni pa nevojë.

Oferta juaj në këtë aktivitet të prokurimit në bazë të dëshmive tregon se nuk jeni palë me interes sipas Nenit 4.1.26 të LPP-së, pasi që oferta juaj nuk është e përgjegjshme administrativisht.

Nga konstatimet e lartcekura u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kjo procedurë është trajtuar konform Ligjit Nr. 04/042, Ligji për Prokurimin Publik në Republikën e Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-92.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi të AK-së ju munde të paraqitni ankesë pranë OSHP-së në pajtim me nenin 109 të LPP-së. Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas vendimit të lëshuar nga Autoriteti Kontraktues.

Vendimi Publikohet:

Në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>

Me respekt:
Zyra e Prokurimit
Komuna e Rahovecit

Data: 17.06.2021